



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:051927

Datë: 22.09.2022

Numri i dokumentit: 03450432

P.nr.101/2021

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj, bashkëpunëtorën profesionale Sandra Fazliu dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurve 1.A., B., nga fshati ...-Komuna Pejë, për shkak të veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), dhe 2. D., B., nga fshati ...-Komuna Pejë, për shkak të veprës penale në ndihmë-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 33 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje: KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.479/2021 të datës 06.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik të datës 07.09.2022, në të cilin prezent ishin prokurori i shtetit Slobodan Bakiq, të pandehurit A.,B., dhe i pandehuri D., B., si dhe përkthyesi i gjykatës Sh., H., më datën 08.09.2022 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 22.09.2022 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1.- I pandehuri **A., B.**, nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë (data e lindjes) në ..., ku edhe tani jeton Rr."..."Komuna .., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

2.- I pandehuri **D., B.**, nga babai .. dhe nëna .., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë (data e lindjes) në ..., ku edhe tani jeton Rr."..."Komuna ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar-baba i një (1) fëmije, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike.

- J A N Ë F A J T O R Ë -

- I pandehuri A., B.,:

I.- SEPSE : Me datë 01.11.2020, rreth orës ..., në fshatin ...-Komuna Skenderaj, ka përdorur si të vërtetë dokumentin e rremë publik, përkatësisht patentë shoferin të lëshuar në emër të tij nr.DL 30203872, të cilën e siguron ashtu që përmes të pandehurit të dytë e njofton një person me emrin ..., me të cilin takohet në kafene, të cilit i pandehuri i parë dhe i pandehuri i dytë ia japin letër-njoftimin dhe fotografitë, që ai t'ua sigurojë patentë shoferin, gjë që edhe e bënë, i bënë patentë shoferët dhe i jepë të pandehurit të parë dhe të dytë, dhe për këtë shërbim i paguajnë 300 Euro, pastaj i pandehuri i parë atë patentë shofer e përdorë deri me datë 01.11.2020, kur duke drejtuar automjetin VW ..., ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit 03-423-EH, e ndalon policia dhe ia sekuestron patentë shoferin të falsifikuar.

- Me këtë ka kryer veprën penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2, lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- I pandehuri D., B., :

II.- SEPSE : Me datë 01.11.2020, rreth orës 03:00, në fshatin ... - Komuna Skenderaj, me vetëdije i ndihmon të pandehurit të parë A., B., në kryerjen e veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 KPRK-së, ashtu që i pandehuri i parë e siguron dokumentin publik të rremë patentë shoferin të cilin i pandehuri i parë e përdorë si të vërtetë, përkatësisht patentë shoferin të lëshuar në emër të tij nr.DL ..., ashtu që i pandehuri i dytë e njofton një person me emrin ..., me të cilin takohen në një kafene, të cilit i pandehuri i parë dhe i dytë ia japin letër-njoftimet dhe fotografitë, në mënyrë që ai person t'ua sigurojë patentë shoferin, gjë që edhe ka vepruar, i ka bërë patentë shoferin dhe ia ka dhënë të pandehurit të parë dhe të dytë, për të cilin shërbim ia kanë paguar 300 Euro, pastaj i pandehuri i parë e përdorë atë patentë shofer deri me datë 01.11.2020, kur edhe e ndalon policia, ndërsa i pandehuri i dytë e përdorë patentë shoferin e rremë deri kur babai i tij e kupton këtë dhe e djegë patentë shoferin e falsifikuar.

- Me këtë ka kryer veprën penale në ndihmë-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2, lidhur me par.1 e lidhur me nenin 33 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 38, 39, 42, 43, 47, 48, 49, 69, dhe 70 të KPRK-së, e lidhur me nenet 115, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, 453 par.1, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit :

- I G J Y K O N -

I.- A., B., me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet me kusht nëse i pandehuri për periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë, nuk kryenë vepër tjetër penale si dhe

Me Dënim me Gjobë në shumën prej katërqind (400.00) Euro, të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditëve prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Diamant B., me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, si dhe me Dënim me gjobë në shumën prej treqind (300.00) Euro, i cili dënim me burgim dhe me gjobë nuk do të ekzekutohen me kusht nëse i pandehuri për **periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë, nuk kryenë vepër tjetër penale.**

III.- Nëse i pandehuri A., B., dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguanë në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së të pandehurit do të ia zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

IV.- Obligohen të pandehurit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro) secili veç e veç dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30.00 € (tridhjetë euro) secili veç e veç, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V.- Konfiskohet në mënyrë të përhershme patentë shoferi i falsifikuar i Republikës së Kosovës me numër DL....

VI.- Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore-juridike, gjykata nuk vendosi fare në procedurë penale.

- A r s y e t i m -

- Rrjedha e çështjes -

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm më datë 05.05.2021, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.479/2021 ndaj të pandehurve : 1. A.,B., nga fshati-Komuna Pejë, për shkak të veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe 2. D., B., nga fshati ...-Komuna Pejë, për shkak të veprës penale në ndihmë-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

- Gjkata në këtë çështje penale më datë 07.09.2022 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar e cila ka qenë e hapur për publikun, në të cilën seancë ishin prezent prokurori i shtetit Slobodan Bakiq, të pandehurit A., B., dhe D., B., si dhe përkthyesi i gjykatës Sh., H.,.

- Gjkata në kuptim të nenit 246 par.1 të KPRK-së, të pandehurit i ka njoftuar me të drejtat e tyre procedurale, ashtu që i pandehuri i parë ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe

se në këtë çështje penale dëshironë të mbrohen vetë, poashtu dhe i pandhëur i dytë ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale dëshironë të mbrohen vetë.

- Vlerësimi i pranimit të fajësisë -

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata të pandehurit i ka njoftuar hollësisht me pasojat dhe beneficionet e pranimit të fajësisë, ashtu që i pandehuri i parë-A., B., ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të përsërisë veprimet e tilla, në fund kërkoi nga gjykata që nëse e shpallë fajtorë t'i shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë, me arsyetimin se lidhur me veprimet e tij është penduar thellësisht për çka sinqerisht kërkojë falje.

-Po ashtu, dhe i pandehuri i dytë-D., B., ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të përsërisë veprimet e tilla, në fund kërkoi nga gjykata që nëse më shpallë fajtorë t'i shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë me arsyetimin se lidhur me veprimet e mija jam penduar thellësisht për çka sinqerisht kërkojë falje.

- Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurori i shtetit, i cili me këtë rast deklaroi se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që t'i aprovojë këto pranimë fajësie.

- Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 par.4 lidhur me par.1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit lidhur me veprat penale të cila iu vihen në barrë sipas kësaj aktakuze ngase konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga të pandehurit dhe se të njëjtit i kanë kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, të cila pranime janë mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjendja faktike e vërtetuar -

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithashë nga pranimi i fajësisë nga të pandehurit, pranimi i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës në raport me të pandehurit, siç ishin : Raporti i oficerit policor Nr.2020-BF-0331 të datës 01.11.2020, lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor Skenderaj, Procesverbalet mbi marrje në pyetje të të pandehurve Nr.2020-BF-0331 të datës 01.11.2020 dhe datë 04.03.2021, lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor Skenderaj, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve Nr.2020-BF-0331 të datës 01.11.2020 lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor Skenderaj, Raporti i Ekspertimit Nr.AFK/2021-0110/2021-102 të datës 27.01.2021 lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Kopja e patentë shoferit në emër të të pandehurit A., B., Nr. DL30203872, Kopja e patentë shoferit në emër të të pandehurit D.. B.. Nr. DL31247954, Certifikata e Regjistrimit të Automjetit CRA 0629181, në emër të N.T.SH "...", si dhe është bërë vështrim në shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurit të parë, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase i njëjti më datë 01.11.2020, rreth orës 03:00, në fshatin ... - Komuna Skenderaj, ka përdorur si të vërtetë dokumentin e rremë publik, përkatësisht patentë shoferin të lëshuar në emër të tij nr.DL ... të cilën e siguron ashtu që përmes të pandehurit të dytë e njofton një person me emrin ..., me të cilin takohet në kafene, të cilit i pandehuri i parë dhe i pandehuri i dytë ia japin letër-njoftimin dhe fotografitë, që ai t'ua sigurojë patentë shoferin, gjë që edhe e bënë, i bënë patentë shoferët, dhe i jepë të pandehurit të parë dhe të dytë, dhe për këtë shërbim i paguajnë 300 Euro, pastaj i pandehuri i parë atë patentë shofer e përdorë deri me datë 01.11.2020, kur duke drejtuar automjetin VW ..., ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit 03-423-EH, e ndalon policia dhe ia sekuestron patentë shoferin të falsifikuar.

- Po ashtu, gjykata vërtetoi se dhe me veprimet inkriminuese të të pandehurit të dytë përmbushen të gjitha elementet e veprës penale në ndihmë-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2, lidhur me par.1 e lidhur me nenin 33 të KPRK-së, ngase i njëjti më datë 01.11.2020, rreth orës 03:00, në fshatin ... - Komuna Skenderaj, me vetëdije i ndihmon të pandehurit të parë A., B., në kryerjen e veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 KPRK-së, ashtu që i pandehuri i parë e siguron dokumentin publik të rremë patentë shoferin të cilin i pandehuri i parë e përdorë si të vërtetë, përkatësisht patentë shoferin të lëshuar në emër të tij nr.DL ..., ashtu që i pandehuri i dytë e njofton një person me emrin ..., me të cilin takohen në një kafene, të cilit i pandehuri i parë dhe i dytë ia japin letër-njoftimet dhe fotografitë, në mënyrë që ai person t'ua siguroj patentë shoferin, gjë që edhe ka vepruar, i ka bërë patentë shoferin dhe ia ka dhënë të pandehurit të parë dhe të dytë, për të cilin shërbim ia kanë paguar 300 Euro, pastaj i pandehuri i parë e përdorë atë patentë shofer deri me datë 01.11.2020, kur edhe e ndalon policia, ndërsa i pandehuri i dytë e përdorë patentë shoferin e rremë deri kur babai i tij e kupton këtë dhe e djegë patentë shoferin e

falsifikuar, për çka gjykata gjeti se i pandehuri i parë dhe i pandehuri i dytë në aspektin penalo-juridik janë përgjegjës dhe iu shqiptojë dënime si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit -

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të pandehurin e parë si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë lehtësuese gjykata mori pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, premtimin gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese për të njëjtin gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të tij.

- Po ashtu, dhe për të pandehurin e dytë si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë lehtësuese gjykata mori pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, se i njëjti është njeri familjar, i martuar baba ..., premtimin gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe se nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa, si rrethanë rënduese për të njëjtin poashtu gjykata gjeti shkallën e latë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të tij.

- Sipas bindjes së gjykatës, dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit të parë dhe të pandehurit të dytë, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, gjykata vlerëson se janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tyre.

- Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të pandehurve iu shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për konfiskim-

- Duke u bazuar në nenin 115 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të konfiskojë në mënyrë të përhershme patentë shoferin e falsifikuar të Republikës së Kosovës me numër DL... lëshuar me datë 20.06.2017 në emër të të pandehurit A., B., pasi që, gjykata ka vërtetuar se i njëjti

është përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale, gjithashtu i njëjti është rezultat i kryerjes së veprës penale nga ky i pandehur, për të cilën u shpallë fajtor dhe iu shqiptua dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike-

- Vendimin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2, nenin 451 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore-juridike, gjykata nuk vendosi fare në procedurë penale.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.101/2021 me datë 22.09.2022.

**Procesmbajtësja,
Florije Gucati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdiqaj**

- KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.